



Bashkia Tiranë

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE



Programi i muajit Qershor për fëmijët 18-24 muajsh

«Karakteristika të muajit Qershor dhe Stinës së Verës»



Çfarë duhet të dimë për Qershorin dhe Stinën e Verës?

- * Stina e verës është stina më e ngrohtë e vitit, ditët janë me diell dhe qielli është i kthjellët.
- * Vera ka tre muaj: Qershorin, Korrikun dhe Gushtin.
- * Në verë dita është më e gjatë se nata, dielli del herët dhe rrezet e tij përkedhelin gjithçka.
- * Në verë mbrëmja vjen më ngadalë dhe ne shikojmë hënën dhe qiellin të mbushur plot me yje, xixëllonjat
- * Lulet shkëlqejnë kudo dhe fluturat i lënë vendin bletëve për të mbledhur nektarin.
- * Kur vjen vera fëmijët ndjehen më të gëzuar, sepse shijojnë pishinat, detin dhe lojërat buzë tij, shëtitjet, akulloret dhe lëngjet e freskëta.
- * Qershori është muaji i parë dhe nis me një ditë të rëndësishme për fëmijët **1 Qershorin**.
- * Në Qershor ne shijojmë frutat dhe perimet e stinës.

Tema e Muajit: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës

Grupi: 18-24 muaj

- * **Java I:** Festa e 1 Qershorit. Njohja me karakteristikat e stinës së verës.
- * **Java II:** Fruta e stinës.
- * **Java III:** Përsërisim ngjyrat dhe numrat përmes veshjeve të stinës së verës.
- * **Java IV:** Format e argëtimit

Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës & Festa e 1 Qershorit

Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Festa e 1 Qershorit dhe karakteristikat e përgjithshme të stinës së verës	Programi festiv. Njohja me disa nga karakteristikat kryesore të stinës së verës.	Java I
Frutat e stinës së verës	Njohja me frutat e stinës.	Java II
Ngjyrat dhe numrat tek veshjet e fëmijëve në verë	Njohja me veshjet karakteristike të fëmijëve për verën.	Java III
Sa gëzim erdhi vera!!!	Format e argëtimit.	Java IV




Shënim:



- * Stafii edukator duhet të zhvillojë bashkë me fëmijët programin për **Festën e 1 Qershorit** në bazë të përgatitjeve që duhet të jenë kryer në muajin Maj.
- * Stafii edukator duhet nisë realizimin e muketit të **Stinën e Verës** në çerdhe.

Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës

Tema e javës I: Festa e 1 Qershorit dhe Karakteristika të Stinës së Verës





Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë		<p>Aktiviteti festiv: Fëmijët në drejtimin e edukatoreve realizojnë programin festiv në çerdhe. Këngë dhe vjersha.</p> <p>Vjersha dhe këngë të realizuara sipas programit vjetor me materiale të përzgjedhura.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
E Martë	<p>Karakteristika të Stinës së Verës</p>  <p>Dielli</p>	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/bisedon me fëmijët për stinën e verës, përdor ilustrime dhe figura për të identifikuar dhe emërtuar diellin, qiellin, yjet etj.</p> <p>Aktivitet: “Futja e rathëve në kon”</p> <p>Këngë lëvizore: “Roza-rozina”</p> <p>Vjersha: “Dielli”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
E Mërkurë	<p>Qielli, yjet dhe hëna</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në verë, qielli është i pastër dhe i kthjellët. (Oborr/dritare)</p> <p>Aktivitet: “Pikturimi me dorë/gishta”</p> <p>Loja energjike me muzikë</p> <p>Vjersha: “Ylli i vogël”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista</p>



<p>E Enjte</p>	<p>Ngjyrat në natyrë</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve për ngjyrat në verë: Deti, qielli është blu. Lulet janë të kuqe etj.</p> <p>Aktivitet: “Me rërë dhe ujë”- Improvizimi i detit/liqenit në një vaskë ose legen me ujë me lodra të ndryshme plastike me ngjyra të kuqe dhe blu (peshq, rosakë, varka etj).</p> <p>Këngë lëvizore : “ Rosat po lahen”</p> <p>Përralla: “Rosaku i shëmtuar”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
<p>E Premte</p>	<p>Zogjtë</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve rreth këtyre zogjve, për ngjyrën e tyre dhe për puplat.</p> <p>Aktivitet i improvizuar në grup: “Rrahim krahët si zogjtë”- edukatoret orientojnë fëmijët të lëvizin krahët si zogjtë.</p> <p>Këngë lëvizore: “Rosat po lahen”</p> <p>Lojra energjike me muzikë</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>

Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës

Tema e javës II: Frutat e Stinës





Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Fruta e stinës së verës</p>  <p>Qershia</p>	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve/demonstron përmes formave plastike, ilustrime figurash të frutave të stinës.</p> <p>Aktivitet: “Futja e frutave në shportë”- Edukatorja emërton secilën prej tyre.</p> <p>Punë dore: “Fëmijët ngjisin format e parapërgatitura nga edukatorja të frutit të Qershisë”.</p> <p>Vjersha: “Qershia”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete didaktike</p>
<p>E Martë</p>	<p>Frutat e ëmbla të verës: Luleshtrydhe</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për frutin e luleshtrydhes. Edukatorja shpjegon se me luleshtrydhe mund të bëhet akullore.</p> <p>Aktivitet: “Futja e frutave në shportë”- emërtimi dhe klasifikimi i frutave sipas ngjyrave.</p> <p>Vjersha: “Luleshtrydhja pikaloshe”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libri “365 rrëfenja para gjumit”. (f.145)</p>




		Këngë lëvizore me muzikë	
E Mërkurë	<p>Bashkojmë frutat</p> 	<p>Punë dore: Fëmijët, duke përdorur format e ndryshme gome të frutave krijojnë frutin e plotë. (bashkimi i frutave të ndara në pjesë, në mungesë të tyre përdorim pazëll)</p> <p>Aktiviteti: “Tuneli i frutave”</p> <p>Loja energjike: “Vigani dhe shkurtabiqi” e drejtuar nga edukatorja.</p> <p>Vjersha: “Luleshtrydhja pikaloshe”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: plastelinë</p>
E Enjte	<p>Mjalti dhe bleta punëtore</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rreth bletës. Bleta ushqehet duke shëtitur nëpër lule. Nga bleta marrim mjaltin. Shoku më i mirë i mjaltit është Ariu.</p> <p>Këngë për fëmijë: “Bleta punëtore”</p> <p>Aktivitet: “Bërja e fluskave”- në ambientet e brendshme ose oborr.</p> <p>Vjersha: “Bleta”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
E Premte	<p>Përsëritje e frutave të stinës</p>	<p>Aktivitet: Parada e frutave të stinës</p> <p>Vjersha: “Luleshtrydhja pikaloshe”</p> <p>Këngë për fëmijë: “Bleta punëtore”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>



Tema mujore: Njohja me karakteristikat e stinës së verës
Tema e javës III: Veshjet e Fëmijëve, Ngjyrat për Stinën e Verës.





Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Veshjet tona shumëngjyrëshe në stinën e verës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në verë vishemi më lehtë pasi është shumë nxehtë. Veshim: bluzë me mëngë të shkurtra, pantallona të shkurtra, funde, fustane, shapka, sandale, atlete, kapela, syze, etj...</p> <p>Aktivitet: “Veshja” Edukatorja emërton veshjet e secilit fëmijë, nxit fëmijët të emërtojnë veshjet.</p> <p>Përrallë: “Një modë e re”</p> <p>Vjersha: “Kam një kukull”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libri “365 rrëfenja para gjumit” (f.86)</p>
<p>E Martë</p>	<p>Përsërisim ngjyrat përmes veshjeve</p>  <p>Dollapi im i veshjeve</p>	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se stina e verës ka shumë ngjyra, veshjet po ashtu në verë janë shumëngjyrëshe. Edukatorja ilustron ngjyrat duke i pyetur fëmijët për ngjyrat e rrobave që kanë veshur.</p> <p>Aktivitet: Edukatorja udhëheq fëmijët të vendosin në dollapin e çerdhës veshjet e tyre.</p> <p>Vizatim/ngjyrosje: “Rrobat e mia shumëngjyrëshe të verës”</p> <p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike Kapela, Syze Libra, revista</p>



<p>E Mërkurë</p>	<p>Krijojmë kapelën me punë dore</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se, kur vjen vera vendosim kapelën në kokë dhe syzet në sy për t'u mbrojtur nga rrezet e diellit. Edukatorja pyet: - Çfarë ngjyre i keni kapelet? Po syzet?</p> <p>Punë dore: “Kapelja prej letre”- me palosje. Edukatorja fton fëmijët të emërtojnë ngjyrën që kanë përdorur për kapelën.</p> <p>Loja energjike: “Tuneli”/Kërcim litari”.</p> <p>Këngë për fëmijë: “Bleta punëtore”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: letra A4 me ngjyra. Materiale të imëta</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Numërojmë veshjet dhe lodrat e plazhit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se kur vjen vera ne shkojmë në plazh/pishina. Me vete marrim lodra: top, kovë, krahëza për notim, lopata me forma të ndryshme etj.</p> <p>Loja: “Treni” Improvizimi i udhëtimit me tren me fëmijët për në plazh, përshëndesim, imitojmë si bën treni etj.</p> <p>Vjersha: “Deti”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Ngjyrat e luleve në verë</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja shoqëron fëmijët në oborr duke treguar për lulet, ngjyrat dhe format e tyre.</p> <p>Aktivitet: Emërtimi i ngjyrave. Improvizimi i mbjelljes së një luleje.</p> <p>Punë dore: “Krijojmë lule me ngjyra”. Fëmijët me ndihmën e edukatores ngjyrosin me bojë lule plastike/kartoni.</p> <p>Vjersha: “Mos e këput lulen”</p>	<p>Manuali i Lojrave</p>

Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës

Tema e javës IV: Sa gëzim që erdhi Vera...! Format e argëtimit.

Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
----------------	----------------	--------------------	-----------------------

<p>E Hënë</p>	<p>Festat tona</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për festat, aktivitetet argëtuese që kalojnë me familjen dhe me shokët. Gjatë festave luajmë, këndojmë, kërcëjmë, por edhe shijojmë ushqime e ëmbëlsira.</p> <p>Aktivitet: “Zgjidh ngjyrën” Të përdorin gota/topa me ngjyra (e kuqe, blu, e gjelbër, e verdhë) Bashkimi i ngjyrave të ngjashme.</p> <p>Vjersha: “Topi im”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Martë</p>	<p>Pasditja ime në këndin e lojrave</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve për këndet e lojrave në lagje/në qytet. Iu shpjegon për rrëshqitëset, shilarëset, lojrat me topa shumëngjyrësh, etj.</p> <p>Aktivitet: “Me rrëshqitëse” Në ambientet e brendshme ose oborr të alternuar sipas moshës.</p> <p>Vjersha: “Ylli vogël”</p> <p>Përralla: “Kësulkuqja”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Teatri me Kukulla</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për shfaqjet e teatrit, personazhet që janë kukulla/njerëz. Ajo iu flet për: Kësulëkuqen, personazhet etj.</p> <p>Përralla: “Kësulëkuqja”</p> <p>Aktivitet: Imitimi i personazheve të përrallës nga edukatoret.</p> <p>Kënga: “Qingji i vogël”</p>	<p>Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>

<p>E Enjte</p>	<p>Shëtitje në liqen</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rreth rosave/patave që mund të shikojnë në liqen.</p> <p>Aktivitet i improvizuar: Imitimi i tingujve dhe lëvizjes së krahëve të rosave/patave në liqen.</p> <p>Punë dore: Ngjyrosja e rosave/patave me forma të përgatitura më parë nga edukatorja</p> <p>Këngë: “Rosat po lahen në liqen”</p>	<p>ManualiiVjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Një ditë në plazh/pishinë</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se kur vjen vera ne shkojmë në plazh, pishina.</p> <p>Aktivitet: “Improvizimi i varkave me ngjyra”. Në një legen me ujë fëmijët vendosin dhe lozin me varkat e përgatitura më parë nga edukatoret.</p> <p>Vjersha: “Deti”</p>	<p>Manuali i Vjershave/Lojrave Mjete Didaktike</p>